



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

## **RAPORTI I KOMISIONIT MBIKQYRËS: JANAR-QERSHOR 2024**

**PËR ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE PLANIT TË VEPRIMIT  
PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE EKONOMIKE**

Dhjetor 2024, Prishtinë

## PËRMBAJTJA

|                                                                               |           |
|-------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Parathënie.....                                                               | 3         |
| Hyrje.....                                                                    | 4         |
| <b>PJESA E PARË: RAPORTI I PËRGJITHSHËM.....</b>                              | <b>5</b>  |
| 1.1 <b>KORRUPSIONI.....</b>                                                   | <b>6</b>  |
| 1.1.1 Kallëzimet e parashtruara nga subjektet publike dhe personat.....       | 7         |
| 1.1.2 Gjendja dhe trajtimi i kallëzimeve.....                                 | 7         |
| 1.1.3 Mënyra e procedimit të personave në kallëzime.....                      | 8         |
| 1.1.4 Ankesat e palëve në prokurorinë e Apelit.....                           | 8         |
| 1.1.5 Vendimet/Veprimet e prokurorisë.....                                    | 9         |
| 1.1.6 Vendimet e Gjykatës.....                                                | 9         |
| 1.1.7 Ankimimi i prokurorisë.....                                             | 9         |
| 1.1.8 Raportet e veçanta PPN.....                                             | 10        |
| 1.1.9 Gjendja dhe trajtimi i raporteve të veçanta PPN.....                    | 10        |
| 1.2 <b>KRIMET EKONOMIKE.....</b>                                              | <b>11</b> |
| 1.2.1 Kallëzimet e parashtruara nga subjektet publike dhe personat.....       | 12        |
| 1.2.2 Gjendja dhe trajtimi i kallëzimeve.....                                 | 12        |
| 1.2.3 Mënyra e procedimit të personave në kallëzime.....                      | 12        |
| 1.2.4 Ankesat e palëve në prokurorinë e Apelit.....                           | 13        |
| 1.2.5 Vendimet/Veprimet e prokurorisë.....                                    | 13        |
| 1.2.6 Vendimet e Gjykatës.....                                                | 13        |
| 1.2.7 Ankimimi i prokurorisë.....                                             | 14        |
| 1.2.8 Raportet e veçanta PPN.....                                             | 14        |
| 1.2.9 Gjendja dhe trajtimi i raporteve të veçanta PPN.....                    | 14        |
| <b>PJESA E DYTË: NJËSITI I PROFILIZUAR NË PTH. PRISHTINË.....</b>             | <b>15</b> |
| 2.1 <b>KORRUPSIONI.....</b>                                                   | <b>16</b> |
| 2.1.1 Gjendja dhe trajtimi i kallëzimeve.....                                 | 16        |
| 2.1.2 Mënyra e procedimit të personave në kallëzime.....                      | 16        |
| 2.1.3 Gjendja dhe trajtimi i raporteve të veçanta PPN.....                    | 16        |
| 2.2 <b>KRIMET EKONOMIKE.....</b>                                              | <b>17</b> |
| 2.2.1 Gjendja dhe trajtimi i kallëzimeve.....                                 | 17        |
| 2.2.2 Mënyra e procedimit të personave në kallëzime.....                      | 17        |
| 2.2.3 Gjendja dhe trajtimi i raporteve të veçanta PPN.....                    | 17        |
| <b>PJESA E TRETË: ASPEKTI KRAHASIMOR: JANAR-QERSHOR 2022, 2023, 2024.....</b> | <b>18</b> |
| 3.1 <b>TË GJITHA PROKURORITË THEMELORE DHE PROKURORIA SPECIALE.....</b>       | <b>19</b> |
| 3.1.1 Korrupsioni.....                                                        | 19        |
| 3.1.2 Krimet ekonomike.....                                                   | 20        |
| 3.2 <b>NJËSITI NË PTH.PRISHTINË.....</b>                                      | <b>22</b> |
| 3.2.1 Korrupsioni.....                                                        | 23        |
| 3.2.2 Krimet ekonomike.....                                                   | 24        |
| 3.2.3 Mospërputhjet e të dhënave statistikore: NJSHPP - Njësiti.....          | 25        |
| <b>PJESA E KATËRT: PËRFUNDIME.....</b>                                        | <b>26</b> |
| 4.1 Konstatime.....                                                           | 27        |
| 4.2 Rekomandime.....                                                          | 29        |

## PARATHËNIE

Në kuadër të realizimit të obligimeve dhe detyrave të parashikuara në Planin strategjik 2013-2015 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me 10-11 maj 2013, nën udhëheqjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ishte organizuar një takim pune i njohur si “Takimi Prevallës”, me të gjithë akterët vendorë<sup>1</sup> dhe ndërkombëtarë me qëllim të përbashkët, krijimin e një mekanizmi përcjellës për zbulimin, hetimin, ndjekjen, gjykimin dhe ndëshkimin e kryesve të veprave penale karakteristike.<sup>2</sup>

Këshilli prokurorial i Kosovës kishte krijuar bazën e të dhënave për regjistrimin e të dhënave për veprat penale karakteristike dhe në fund të vitit 2013 kishte publikuar raportin e parë vjetor për vitin 2013. Nga ky raport KPK-ja, ka identifikuar dy çështje të cilat kërkonin angazhim shtesë: 1. Lëndët e Korrupsionit të cilat përbënin mbi 50% lëndëve nga numri i përgjithshëm i veprave penale karakteristike, dhe 2. Sekuestrimi dhe Konfiskimi.

1. Lidhur me lëndët e korrupsionit, KPK-ja në vitin 2013, kishte miratuar “Planin e veprimit” nr.1285/2013<sup>3</sup> për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe kishte caktuar një koordinator për mbikëqyrjen e zbatimit të planit.<sup>4</sup>
2. Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2014, kishte nënshkruar “Memorandum bashkëpunimi” nr: 231/2014,<sup>5</sup> me institucionet relevante për themelimin dhe funksionalizimin e koordinorit kombëtar për luftimin e krimeve ekonomike, gjegjësisht për ndjekjen e kryesve të veprave penale, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.<sup>6</sup>

Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkundër angazhimeve në këto dy tema, ka konstatuar nevojën për një ngritje të angazhimit dhe sinkronizim të punëve në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Këshilli për ngritjen e efikasitetit në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, ka hartuar këtë plan strategjik tre vjeçar (2016-2018), përmes të cilit synohet ngritja e efikasitetit dhe zvogëlimi i lëndëve të pazgjidhura të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike<sup>7</sup>.

Plani strategjik përmban disa qëllime, por duke mos u kufizuar: Zvogëlimi i numrit të lëndëve të pazgjidhura, objekt i kësaj strategjie; Rritja e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja; Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me institucione; Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të specializuara; Llogaridhënia dhe transparencia; Analiza e të dhënave statistikore për lëndët e Korrupsionit dhe krimeve ekonomike në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kishte adresuar nevojën për krijimin e një njësie të veçantë në kuadër të dy departamenteve (Departamenti për krime të rënda dhe Departamenti përgjithshëm) të cilat nga 1 janari 2016 ka filluar trajtimin me lëndët e reja të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Me planin strategjik ishin krijuar edhe mekanizmi mbikëqyrës për zbatimin e strategjisë.

1. Komisionin Mbikëqyrës ka për detyrë të vlerësoj veprimet e ndërmarra nga prokurorët e prokurorive themelore dhe PSRK-së në luftimin e korrupsionit, dhe
2. Koordinatorin Kombëtar për luftimin e krimeve ekonomike për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

Në kuadër të këtij plani strategjik është inkorporuar “Plani i Veprimit”, përmes të cilit është krijuar metodologjia e punës për rritjen e efikasitetit në trajtimin e lëndëve të korrupsionit, krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

<sup>1</sup> Institucionet dhe subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor.

<sup>2</sup> Armët, drogat, kontrabandimi me migrantë, krimi organizuar, korrupsioni, shpërlarja e parasë, trafikimi me njerëz, dhe fshehja e dokumenteve të identifikimit të migrantëve, ndërsa në vitin 2014 është shtuar grupi i veprave penale të krimeve ekonomike.

<sup>3</sup> Shih: [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani\\_i\\_Veprimit\\_per\\_Rritjen\\_e\\_Efikasitetit\\_te\\_Sistemit\\_Prokurorial.pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani_i_Veprimit_per_Rritjen_e_Efikasitetit_te_Sistemit_Prokurorial.pdf)

<sup>4</sup> Shih: [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1363.2013-Vendim-Laura\\_Pula\\_emerohet\\_Kordinatore\\_nacionale\\_.pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1363.2013-Vendim-Laura_Pula_emerohet_Kordinatore_nacionale_.pdf)

<sup>5</sup> Shih: [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014\\_-\\_Memorandum\\_Bashkepunimi\\_fin.pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014_-_Memorandum_Bashkepunimi_fin.pdf)

<sup>6</sup> Shih: [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1512.2013\\_-\\_Vendim\\_-\\_per\\_Shqipdon\\_Fazliu\\_-\\_Kordinator\\_Kombetare\\_-\\_KPK.pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1512.2013_-_Vendim_-_per_Shqipdon_Fazliu_-_Kordinator_Kombetare_-_KPK.pdf)

<sup>7</sup> Autori i këtij raporti ka qenë njëri prej anëtarëve të grupit punues për hartimin e planit strategjik 2016-2018.

## HYRJE

Ky raport i Komisionit Ad-hoc mbikëqyrës, në tërësinë e tij pasqyron gjendjen dhe trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, në të gjitha prokuroritë themelore dhe prokurorinë speciale, për periudhën janar-qershor 2024.

Objekt i trajtimit në këtë raport janë veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike të klasifikuara dhe kategorizuara në Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional.

Në pjesën e parë të raportit pasqyrohen të dhënat e përgjithshme, duke përfshirë:

- Të dhënat për numrin e kallëzimeve të parashtruara gjatë periudhës janar-qershor 2024 nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale (organet publike dhe personat);
- Gjendjen dhe trajtimin e kallëzimeve,
- Mënyrën e procedimit të personave në kallëzime,
- Ankesat e palëve në prokurorinë e Apelit,
- Vendimet dhe veprimet e prokurorive,
- Vendimet e gjykatës,
- Ankimimi i prokurorive,
- Të dhënat për numrin e raporteve të veçanta PPN, të parashtruara gjatë periudhës janar-qershor 2024 nga subjektet parashtruese të kallëzimeve (organet publike dhe personat);
- Gjendja dhe trajtimi i raporteve të veçanta PPN.

Në pjesën e dytë të raportit pasqyrohen të dhënat e Njësitit të profilizuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, duke përfshirë:

- Gjendjen dhe trajtimin e kallëzimeve,
- Mënyrën e procedimit të personave në kallëzime,
- Gjendjen dhe trajtimin e raporteve të veçanta PPN.

Aspekti krahasimor i trajtimit të rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën e njëjtë gjashtë mujore të viteve 2022, 2023 dhe 2024 pasqyrohet në pjesën e tretë të raportit. Në këtë pjesë adresohet aspekti krahasimor dhe përmes saj performanca e prokurorive themelore dhe prokurorisë speciale në trajtimin e rasteve, objekt të këtij raporti. Në këtë pjesë pasqyrohet performanca e prokurorëve të Njësitit të profilizuar në prokurorinë themelore në Prishtinë. Theksojmë se që ky është raporti i vetëm në sistemin prokurorial në të cilin që nga raporti i parë në prill 2016 (periudha tremujore janar-mars 2016) janë pasqyruar emrat dhe performanca e prokurorëve të Njësitit në PTh.Prishtinë.

Në pjesën përfundimtare janë adresuar të gjeturat dhe rekomandimet e nevojshme për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Si përfundim theksojmë gjatë periudhës raportuese: janar-qershor 2024, Ad-hoc mbikëqyrës, ka punuar në këtë përbërje:

1. Arian Gashi (kryesues) anëtar prokuror i Këshillit Prokurorial të Kosovës,
2. Laura Pula (anëtare) prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit
3. Arben Ismajli (anëtar), prokuror në prokurorinë e Apelit.
4. Besim Kusari, (*vullnetarisht*) Koordinator i komisioneve të përhershme të Këshillit<sup>8</sup>.

---

<sup>8</sup> Autor i Planit strategjik (2016-2018) dhe planit të veprimit për ngritjen e efikasitetit në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe hartues i të gjitha raporteve të Komisionit Ad-hoc mbikëqyrës gjatë viteve 2016-2024.

PJESA E PARË  
RAPORTI I PËRGJITHSHËM  
GJENDJA DHE TRAJTIMI I RASTEVE TË KORRUPSIONIT DHE  
KRIMEVE EKONOMIKE NË PROKURORITË THEMELORE DHE PSRK

# KORRUPSIONI

Veprat penale që përbëjnë grupin e Korrupsionit në Mekanizmin Përcjellës Ndërinstitucional.

| Nenet sipas kodit të ri dhe të vjetër penal: |                 |                 | CILËSIMI I VEPRAVE PENALE SIPAS KALLËZIMIT PENAL                                                   |
|----------------------------------------------|-----------------|-----------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                              | Kodi ri, (Neni) | Kodi vj. (Neni) | Veprat penale që kanë të bëjnë me KORRUPSIONIN ( “KORR”)                                           |
| 1                                            | 284             | 290             | Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike                                                              |
| 2                                            | 285             | 291             | Lidhja e kontratës së dëmshme                                                                      |
| 3                                            | 310             | 316             | Dhënja e rryshfetit në sektorin privat/Dhënia e paarsyeshme e dhuratave                            |
| 4                                            | 399             | 530             | Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria                                            |
| 5                                            | 414             | 422             | Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar                                                      |
| 6                                            | 416             | 423             | Keqpërdorimi i informatës zyrtare                                                                  |
| 7                                            | 417             | 424             | Konflikti i interesit                                                                              |
| 8                                            | 418             | 425             | Përvetësimi në detyrë                                                                              |
| 9                                            | 419             | 426             | Mashtrimi në detyrë                                                                                |
| 10                                           | 420             | 427             | Përdorimi i paautorizuar i pasurisë                                                                |
| 11                                           | 421             | 428             | Marrja e rryshfetit                                                                                |
| 12                                           | 422             | 429             | Dhënia e rryshfetit                                                                                |
| 13                                           | 423             | 430             | Dhënia e rryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar                           |
| 14                                           | 424             | 431             | Ushtrimi i ndikimit                                                                                |
| 15                                           | 425             | 432             | Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore                                                    |
| 16                                           | 426             | 433             | Zbulimi i fshehtësisë zyrtare                                                                      |
| 17                                           | 427             | 434             | Falsifikimi i dokumentit zyrtar                                                                    |
| 18                                           | 428             | 435             | Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme                                                               |
| 19                                           | 429             | 536             | Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor |

## 1.1. KORRUPSIONI

### 1.1.1. KALLËZIMET E PARASHTRUARA NGA ORGANET PUBLIKE DHE PERSONAT

Subjektet kanë parashtruar nëpër prokurori 272 raste të reja, me 680 persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit (figura 1).

|    |      | SPECIALE |     | PRISHTINË |     | PRIZREN |    | PEJË |    | GJILAN |    | MITROVICË |   | FERIZAJ |    | GJAKOVË |    | #   |     |
|----|------|----------|-----|-----------|-----|---------|----|------|----|--------|----|-----------|---|---------|----|---------|----|-----|-----|
|    |      | R        | P   | R         | P   | R       | P  | R    | P  | R      | P  | R         | P | R       | P  | R       | P  | R   | P   |
| 1  | AKK  |          |     |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    |         |    |     |     |
| 2  | AKP  |          |     |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    | 1       | 1  | 1   | 1   |
| 3  | APK  |          |     |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    | 1       | 4  | 1   | 4   |
| 4  | ATK  |          |     |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    |         |    |     |     |
| 5  | DK   |          |     |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    |         |    |     |     |
| 6  | ID   |          |     | 58        | 88  |         |    |      |    |        |    |           |   | 5       | 54 | 2       | 2  | 65  | 144 |
| 7  | IPK  |          |     | 4         | 7   | 1       | 1  | 1    | 1  | 16     | 47 |           |   |         |    | 1       | 1  | 23  | 57  |
| 8  | NJIF |          |     |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    |         |    |     |     |
| 9  | OAK  |          |     | 2         | 2   |         |    |      |    | 1      | 3  |           |   |         |    |         |    | 3   | 5   |
| 10 | PK   | 2        | 3   | 35        | 146 | 12      | 15 | 9    | 30 | 2      | 3  | 3         | 7 | 26      | 27 | 7       | 20 | 96  | 251 |
| 11 | PV   | 2        | 20  |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    |         |    | 2   | 20  |
| 12 | Q    | 51       | 145 | 2         | 4   | 17      | 32 | 1    | 1  |        |    |           |   | 2       | 4  | 7       | 9  | 80  | 195 |
| 13 | TP   |          |     |           |     |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    |         |    |     |     |
| 14 | AGJ  |          |     | 1         | 3   |         |    |      |    |        |    |           |   |         |    |         |    | 1   | 3   |
|    | #    | 55       | 168 | 102       | 250 | 30      | 48 | 11   | 32 | 19     | 53 | 3         | 7 | 33      | 85 | 19      | 37 | 272 | 680 |

Figura 1

### 1.1.2. GJENDJA DHE TRAJTIMI I KALLËZIMEVE

Nga periudhat e kaluara janë bartur 550 raste PP me 1555 persona, janë pranuar 272 raste PP me 680 persona ndërsa, 9 raste me 13 persona kanë kaluar nga regjistri PPN në regjistrin PP. Nga tërësia prej 831 rasteve me 2248 persona, prokuroritë kanë proceduar 199 raste PP (24%) me 499 persona, ndërsa në fund të periudhës kanë mbetur 632 raste PP me 1749 persona (figura 2).

|   |           | TË BARTURA |      | TË REJA |     | NGA PPN NË PP |    | GJITHSEJ |      | PROCEDUAR |     | TË MBETURA |      |
|---|-----------|------------|------|---------|-----|---------------|----|----------|------|-----------|-----|------------|------|
|   |           | R          | P    | R       | P   | R             | P  | R        | P    | R         | P   | R          | P    |
| 1 | SPECIALE  | 74         | 326  | 55      | 168 |               |    | 129      | 494  | 31        | 150 | 98         | 344  |
| 2 | PRISHTINË | 246        | 624  | 102     | 250 |               |    | 348      | 874  | 90        | 162 | 258        | 712  |
| 3 | PRIZREN   | 48         | 121  | 30      | 48  | 2             | 2  | 80       | 171  | 24        | 46  | 56         | 125  |
| 4 | PEJË      | 24         | 70   | 11      | 32  | 5             | 8  | 40       | 110  | 11        | 39  | 29         | 71   |
| 5 | GJILAN    | 7          | 20   | 19      | 53  | 2             | 3  | 28       | 76   | 11        | 32  | 17         | 44   |
| 6 | MITROVICË | 107        | 260  | 3       | 7   |               |    | 110      | 267  | 8         | 12  | 102        | 255  |
| 7 | FERIZAJ   | 29         | 112  | 33      | 85  |               |    | 62       | 197  | 10        | 32  | 52         | 165  |
| 8 | GJAKOVË   | 15         | 22   | 19      | 37  |               |    | 34       | 59   | 14        | 26  | 20         | 33   |
|   | #         | 550        | 1555 | 272     | 680 | 9             | 13 | 831      | 2248 | 199       | 499 | 632        | 1749 |

Figura 2

### 1.1.3. MËNYRA E PROCEDIMIT TË PERSONAVE NË KALLËZIME

Prokuroritë kanë proceduar rastet e 499 personave: për 44% të personave kanë hedhur kallëzimin penal, për 22% të personave kanë pushuar hetimin, për 31% të personave kanë ngritur aktakuzës, ndërsa për 3% të personave kanë bashkuar procedurën (figura 3).

|   |           | Persona | Hedhje e kallëzimit penal | Është hudhur për shkak të marrëveshjes për ndërmjetësim | Pushim i hetimit | Aktakuzë për dhënien e urdhërit ndëshkimor | Aktakuzë e drejtpërdrejt | Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve | Mënyrë tjetër (Bashkrimi i procedurës) |
|---|-----------|---------|---------------------------|---------------------------------------------------------|------------------|--------------------------------------------|--------------------------|-------------------------------------|----------------------------------------|
| 1 | SPECIALE  | 150     | 61                        |                                                         | 38               |                                            |                          | 51                                  |                                        |
| 2 | PRISHTINË | 162     | 110                       |                                                         | 20               |                                            |                          | 32                                  |                                        |
| 3 | PRIZREN   | 46      | 27                        |                                                         | 12               |                                            |                          | 5                                   | 2                                      |
| 4 | PEJË      | 39      | 6                         |                                                         | 8                |                                            |                          | 21                                  | 4                                      |
| 5 | GJILAN    | 32      | 4                         |                                                         | 14               |                                            |                          | 14                                  |                                        |
| 6 | MTROVICË  | 12      |                           |                                                         | 8                |                                            |                          | 4                                   |                                        |
| 7 | FERIZAJ   | 32      | 5                         |                                                         | 10               |                                            |                          | 17                                  |                                        |
| 8 | GJAKOVË   | 26      | 7                         |                                                         |                  |                                            |                          | 10                                  | 9                                      |
|   | #         | 499     | 220                       |                                                         | 110              |                                            |                          | 154                                 | 15                                     |

Figura 3

### 1.1.4. ANKESAT E PALËVE NË PROKURORINË E APELIT

Prokuroria e Apelit ka pranuar 349 ankesa të palëve kundër aktvendimeve të prokurorive për huthje të kallëzimit penal, pushim të hetimeve apo kundër dështimit të prokurorive për të ndërmarrë veprime brenda afatit 6 mujor. Nga tërësia e ankesave të pranura, prokuroria e Apelit ka hedhur 41 apo 12% të ankesave, ka refuzuar 146 apo 42% të ankesave, ka aprovuar 77 apo 22% të ankesave, ndërsa 85 apo 24% të ankesave janë në proces<sup>9</sup> (figura 4).

|   |           | Ankesa kundër Aktvendimit për huthje të plotë ose të pjesërishtë të kallëzimit penal |        |          |          |           | Ankesa kundër Aktvendimit për pushimin e plotë ose të pjesërishtë të hetimit |        |          |          |           | Ankesa kundër dështimit të prokurorit të prokurorisë për të ndërmarrë veprime brenda afatit prej 6 muajsh. |        |          |          |           | GJITHSEJ |        |          |          |           |
|---|-----------|--------------------------------------------------------------------------------------|--------|----------|----------|-----------|------------------------------------------------------------------------------|--------|----------|----------|-----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|----------|----------|-----------|----------|--------|----------|----------|-----------|
|   |           | Pranuar                                                                              | Hedhur | Refuzuar | Aprovuar | Në proces | Pranuar                                                                      | Hedhur | Refuzuar | Aprovuar | Në proces | Pranuar                                                                                                    | Hedhur | Refuzuar | Aprovuar | Në proces | Pranuar  | Hedhur | Refuzuar | Aprovuar | Në proces |
| 1 | SPECIALE  |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 53       | 8      | 26       | 3        | 16        |
| 2 | PRISHTINË |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 127      | 22     | 52       | 36       | 17        |
| 3 | PRIZREN   |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 33       | 3      | 14       | 6        | 10        |
| 4 | PEJË      |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 18       | 3      | 11       | 1        | 3         |
| 5 | GJILAN    |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 43       | 1      | 17       | 11       | 14        |
| 6 | MTROVICË  |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 14       | 3      | 4        | 3        | 4         |
| 7 | FERIZAJ   |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 29       |        | 7        | 12       | 10        |
| 8 | GJAKOVË   |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 32       | 1      | 15       | 5        | 11        |
|   | #         |                                                                                      |        |          |          |           |                                                                              |        |          |          |           |                                                                                                            |        |          |          |           | 349      | 41     | 146      | 77       | 85        |

Figura 4

<sup>9</sup> Nga DTI janë ofruar vetëm sasia e përgjithshme e ankesave të gjeneruara nga SMIL, pa ndarje/kategorizim sipas aktvendimit për huthje, pushim ose dështim të prokurorët që brenda 6 muajve të ndërmerr veprime.



### 1.1.5. VENDIMET/VEPRIMET E PROKURORISË

Prokuroritë kanë marrë 117 vendime/veprime në kuadër të trajtimit të rasteve të personave të përfshirë në veprat penale. Gjykatat kanë aprovuar 12 (apo 75%) nga 16 kërkesat për caktimin e paraburgimit (figura 5).

|   |           | Numri vendimeve | Urdhëresa për ndalim | Kërkesa për informata aktuale | Kërkesa për informata të fsheshta | Aktivitetim për fillimin e hetimit | Kërkesa për caktimin e paraburgimit | Kërkesa për caktimin e paraburgimit të aprovuar nga Gjykata | Ankesa në vendimet e Gjykatës përkatësi refuzimin e kërkesës | Vendimet e Gjykatës së Apelit në lidhje me ankesat | Aktivitetim për zgjerimin e hetimit | Pezullim i procedurës | Rifillimi i procedurës pas pezullimit të hetimit |
|---|-----------|-----------------|----------------------|-------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------|--------------------------------------------------|
| 1 | SPECIALE  | 38              |                      | 3                             |                                   | 24                                 | 3                                   |                                                             |                                                              |                                                    | 4                                   | 2                     | 2                                                |
| 2 | PRISHTINË | 2               |                      |                               |                                   |                                    | 2                                   | 2                                                           |                                                              |                                                    |                                     |                       |                                                  |
| 3 | PRIZREN   | 44              | 8                    | 2                             |                                   | 23                                 | 8                                   | 8                                                           |                                                              |                                                    | 1                                   |                       | 2                                                |
| 4 | PEJË      |                 |                      |                               |                                   |                                    |                                     |                                                             |                                                              |                                                    |                                     |                       |                                                  |
| 5 | GJILAN    | 16              |                      |                               |                                   | 16                                 |                                     |                                                             |                                                              |                                                    |                                     |                       |                                                  |
| 6 | MITROVICË | 2               |                      |                               |                                   | 2                                  |                                     |                                                             |                                                              |                                                    |                                     |                       |                                                  |
| 7 | FERIZAJ   | 14              |                      |                               |                                   | 10                                 | 2                                   | 2                                                           |                                                              |                                                    | 2                                   |                       |                                                  |
| 8 | GJAKOVË   | 1               |                      |                               |                                   |                                    | 1                                   |                                                             |                                                              |                                                    |                                     |                       |                                                  |
|   | #         | 117             | 8                    | 5                             |                                   | 75                                 | 16                                  | 12                                                          |                                                              |                                                    | 7                                   | 2                     | 4                                                |

Figura 5

### 1.1.6. VENDIMET E GJYKATËS

Gjykatat kanë marrë 92 vendime: për 5% të akuzuarve kanë hedhur aktakuzën para shqyrtimit gjyqësor, 57% të akuzuarve i kanë shpallur fajtor, 30% të akuzuarve i ka liruar ndërsa, për 8% të akuzuarve ka refuzuar aktakuzën (figura 6).

|   |           | Numri personave | Është hulumtuar Aktakuza para Shqyrtimit Gjyqësor | I akuzuari është shpallur FAJTOR | I akuzuari është LIRUAR | Është REFUZUAR Aktakuza |
|---|-----------|-----------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|-------------------------|-------------------------|
| 1 | SPECIALE  | 10              |                                                   | 8                                | 1                       | 1                       |
| 2 | PRISHTINË | 36              |                                                   | 22                               | 9                       | 5                       |
| 3 | PRIZREN   | 9               |                                                   | 7                                | 2                       |                         |
| 4 | PEJË      | 5               |                                                   | 4                                | 1                       |                         |
| 5 | GJILAN    | 6               |                                                   | 2                                | 4                       |                         |
| 6 | MITROVICË |                 |                                                   |                                  |                         |                         |
| 7 | FERIZAJ   | 26              | 5                                                 | 9                                | 11                      | 1                       |
| 8 | GJAKOVË   |                 |                                                   |                                  |                         |                         |
|   | Gjithsej: | 92              | 5                                                 | 52                               | 28                      | 7                       |

Figura 6

### 1.1.7 ANKIMIMI I PROKURORISË

Prokuroritë kanë parashtruar 27 ankesa në Gjykatën e Apelit, prej tyre 4 apo 17% janë aprovuar ndërsa 20 apo 83% janë refuzuar (figura 7).

|   |           | Ankesa | Ankesat e Prokurorit kanë të bëjnë me               |                                                 | Ankesat e Aprovuara nga Gjykata e Apelit | Ankesat e refuzuara nga Gjykata e Apelit | Përgjigjja e Prokurorit në ankesën e parashtruar nga pala e akuzuar: |
|---|-----------|--------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|
|   |           |        | Vetëm për vendimin mbi denimin (lartësin e denimit) | Për arsytet tjera (përveç vendimit mbi denimin) |                                          |                                          |                                                                      |
| 1 | SPECIALE  | 1      | 1                                                   |                                                 |                                          | 1                                        |                                                                      |
| 2 | PRISHTINË | 12     | 11                                                  | 1                                               |                                          | 12                                       |                                                                      |
| 3 | PRIZREN   | 4      | 2                                                   | 2                                               | 3                                        | 1                                        |                                                                      |
| 4 | PEJË      |        |                                                     |                                                 |                                          |                                          |                                                                      |
| 5 | GJILAN    | 3      |                                                     | 3                                               |                                          | 1                                        |                                                                      |
| 6 | MITROVICË | 5      | 4                                                   | 1                                               | 1                                        | 3                                        |                                                                      |
